



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:056391
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517876

Ac.nr.4387/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi - Kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Biondina Zeneli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.B nga....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat F.A nga....., kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe pagesën e shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga e paditura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1470/2020, i datës 21.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit –Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan –Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1470/2020, i datës 21.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1470/2020, i datës 21.06.2023 ka vendosur si në vijim:

*“I.MIRATOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.B nga....., dhe **DETYROHET** e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Gjilanit, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, t’ia paguajë shumën monetare prej 1,440.00 euro (për 720 ditë në vlerë prej 2 euro në ditë), për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më 13.03.2020, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 20 vite përvojë pune (75% e pagës bazë), t’ia paguaj shumën prej 314.43 euro, gjithsej shumën e përgjithshme prej 1,754.25 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 14.04.2020 (datë e dorëzimit të padis në Gjykatë), e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjyqimit, nën pasoja e përmbarrimit ligjor .*

II. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën monetare prej 135 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës ashtu që të prishet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë si i pabazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës, ta aprovojë ankesën, ta prishë aktgjykimin dhe padinë e kërkesëpadinë ta refuzojë në tërësi në këtë çështje juridike si të pabazuar në ligj dhe ta prishë aktgjykimin e atakuar, si dhe ta kthejë rastin në rigjykim/rivendosje.

Palës paditëse i është dorëzuar ankesa, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi R.B ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit –Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan pranë Gjykatës Themelore në Gjilan me datë 14.04.2020, me anë të së cilës ka kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimi për ditët e pranisë në punë.

Gjykata e shkallës së parë pa mbajtur shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.1470/2020, i datës 21.06.2023 me të cilin e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se pas pranimit të përgjigjes në padi, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk rezulton të jetë kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është e themeltë. Gjykata ka vërtetuar se paditësi është mësimdhënës i gjuhës frengje në Gjimnazin “ Zenel Hajdini “ në Gjilan, paga bazë e të cilit është 465.58 euro dhe ka përvojë pune mbi 20 vite, si dhe i njëjti ka 720 ditë pune. Andaj Gjykata, duke iu referuar nenin 35, par 8, pika 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune t’ia paguaj shumën prej 314.43 euro. Ndërsa sa i përket kompensimit të ushqimit, duke iu referuar nenit 35 par 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka obliguar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën prej 850 euro në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me kërkesën e paditësit se është përfshirë në parashkrim, mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, për faktin se paditësi padinë e ka paraqitur me datën 14.04.2020, i njëjti ka përvojë pune 23 vite , ashtu siç vërtetohet me vërtetimin e Gjimnazit “Zenel Hajdini” në Gjilan, me nr...../..... të datës 12.12.2019. Për më tepër Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi në kohën e arritjes së kërkesës së paditësit për shpërblim jubilar, e duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të punës, andaj rezulton se padia e paditësit është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç ka pretenduar e paditura.

Gjykata po ashtu, ka konstatuar se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plot me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimi i të paditurës rreth mungesës së kompetencës nuk qëndron sepse me nenin 2.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik ka paraparë kategorinë e nëpunësve civil, në të cilën kategori nuk hyjnë shërbimet publike nga fusha e arsimit e cila dispozitë në mënyrë shprehimore ka paraparë: *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* Me nenin 2.2 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik përcaktohet se: “zyrtaret publik i ka definuar në katër kategori dhe atë: nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës, ndërsa me nenin 4 të po këtij ligji ka paraparë: *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejtë për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*”

Me nenin 6.4.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet: *Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët: Të pakualifikuar: punëtorët teknikë, rojat e natës. Të kualifikuar: servirueset, kuzhinieret, vozitësit, fokistët, bibliotekarët, sekretarët, përkthyesit në qendrat burimore, psikologët, pedagogët, mësuesi asistentë, pediatri dhe stomatologu, mësuesit klasorë, arsimtarët lëndorë, zëvendës drejtorët dhe drejtorët*”.

Gjykata Supreme e Kosovës në Mendimin Juridik Nr.42/2023 ka konstatuar se në raport me pozitat si: drejtor, zëvendës drejtor dhe sekretar zbatohen dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Ligjit të Punës që rrjedhimisht procedura për kompensim duhet të udhëhiqet sipas rregullave të procedurës kontestimore sikurse është vepruar me të drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Pretendimet për aplikim të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës nuk qëndrojnë sepse me nënshkrimin e Kontratës Kolektive punëdhënësi e ka pas detyrim kompensime të tilla dhe paditësi nuk ka pasur obligim që paraprakisht t’i drejtohet të paditurës, e madje nuk vlejnjë as afatet sepse afatet sipas nenit 78 dhe 79 i referohen më tepër procedurave dicitore.

E drejta e paditësit gjen mbështetje në nenet: 35.7 dhe 35.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, me nenin 35.7 përcaktohet se: “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë”. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, ndërsa me nenin 35.8 përcaktohet se: “*Punëtorët anëtarët e (SBASHKU-të), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 8, 8.2, për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3, Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6, shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4387/2023, me datë 27.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v